



Buletini Informativ

- * Hyrje
- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar
 - * Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)
- * Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
 - * Aktivitetet për Profesionat e Lira

Dhjetor 2020

Hyrje

Ngritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve duke përfshirë edhe profesionistët e tjerë ligjor ka vazhduar edhe gjatë muajit dhjetor përmes platformës online Zoom si dhe eleraning, përkatësisht kurset e mësimit në distancë.

Në këtë periudhe raportuese Akademia e Drejtësisë ka punuar intenzivisht në realizimin e aktiviteteve sipas planeve të veprimit të zhvilluara paraprakisht si dhe në përgatitjen e Planit të Punës për vitin 2021.

Përveç trajnimeve, përmes platformës virtuale janë realizuar edhe një pjesë e konsiderueshme e takimeve me bashkëpunëtorë dhe donatorë të Akademisë të cilat kishin qëllim bashkëpunimin dhe koordinimin reciprok në zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta.

Muaji dhjetor karakterizohet me një mori aktiviteteve trajnuese të fokusuara vetëm tek trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe për profesionet e lira, përkatësisht për përmbaruesit privat.

Përmes këtij buletini informativ në vijim pasqyrohen takimet nga bashkëpunimi ndërinstytucional, me donatorët dhe projektet me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta, aktivitetet në dobi të hartimit të programit trajnues për vitin 2021-2022, aktivitetet e realizuara nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme të specifikuara sipas temës së trajnimit, kohëzgjatjes dhe përfituesve të saj si dhe trajnimet për stafin administrativ si dhe përmbaruesit privat.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, buletini informativ përmban edhe njoftimin dhe zhvillimet sa i përket kurseve trajnuese të realizuara në platformën e mësimit në distancë gjatë muajit dhjetor.

Aktivitetet të përgjithshme

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktivitetet e përbashkëta me donatorët dhe projektet

Bashkëpunimi ndërinstitucional si dhe aktivitetet me donatorë kanë vazhduar edhe për gjatë muajit dhjetor. Me qëllim të koordinimit të punëve të përbashkëta janë realizuar takime, punëtori, konferenca dhe aktivitetet tjera si në vijim:

Janë vazhduar takimet e rregullta javore me përfaqësuesin e projektit të BE / EUKOJUST, z. Dragomir Yordanov. Në këto takime janë diskutuar nevojat dhe sfidat e AD-se në përmbushjen e mandatit ligjor, mundësia e mbështetjes së projektit në ngritjen e kapaciteteve të AD në udhëheqjen, organizimin dhe vlerësimin e programeve trajnuese.

AD ne koordinim me zyrën e OPDAT pranë Ambasadës së SHBA-se në Kosovë dhe Projektin e EU / EKOJUST , kane zhvilluar takimin e parë koordinues. Në takim ka marrë pjesë edhe z. John Moreno , nga zyra Qendra për Avokim dhe Trajnim e Departamentit të Shtetit të SHBA-së. Në takim kryesisht është diskutuar koordinimi i aktivitetëve në mbështetje të AD -së, fushat që do të mbulohen nga secila palë dhe shkëmbimi i informatave në lidhje me avancimin dhe fuqizimin e AD-së.

AD me ftesë të Departamentit për Profesionet e Lira në MD si dhe përfaqësuesin e kabinetit të Ministrisë të MD dhe në koordinim me zyrën e INL pranë Ambasadës së SHBA-së në Kosovë, kane zhvilluar një takim trepalësh ku është diskutuar fuqizimi i ndërmjetësimit. AD do të mbështes projektin për fuqizimin e ndërmjetësimit nëpërmjet trajnimeve, fillimisht në organizimin e programit të

trajnit për trajner TT e më pas edhe trajnimet në fushat specifike të ndërmjetësimit.

AD ka marr pjesë në takimin e radhës të Komitetit Drejtues të nismës së KE / Veprimi Facilitues Horizontal i Projektit HELP për vendet e Ballkanit Perëndimorë, në të cilin janë diskutuar të arriturat gjatë vitit 2020 dhe planifikimet për vitin 2021.

AD ka marr pjesë në takimin e Komitetit Drejtues të projektit të KE-së PECK III , i cili një pjesë të madhe të aktivitetëve do të realizojë nëpërmjet trajnimeve në luftën kundër korrupsionit, konfliktit të interesit, pastrimit të parave dhe ligjit të sinjalizuesve.

AD është takuar edhe me këshilltarët e ekipit të rishikimit funksional të sektorit të drejtësisë, ku kane dhënë komentet në lidhje me masat dhe politikat e rekomanduara për strategjinë finale.

AD gjithashtu ka marr pjesë në Konferencë e Nivelit të Lartë për Konventën e Stambollit, të organizuar nga Këshilli i Evropës dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Një nder fituesit e çmimeve për respektimin e ligjit për gjuhët është edhe AD, edhe pse jo fituese e çmimeve kryesore, zyra e Komisionarit për gjuhët në kuadër të ZKM dhe OSBE-së, ka përshëndetur punën e shkëlqyer të AD-se në ofrimin e materialeve dhe të dhënave në portalin e saj në të gjitha gjuhët zyrtare.

AD gjatë kësaj periudhe është takuar edhe me z. Christopher Marshall, Drejtor i Projektit Regjional për sundim të ligjit i financuar nga Mbretëria e Bashkuar dhe implementuar nga Chemonics International. Në takim u diskutua koordinimi i asistencës ndërkombëtarë në Kosovë, nevoja për koordinim dhe bashkëpunim në shkëmbim të praktikave në fushën e trajnimeve.

AD në dhjetor të këtij viti ka marr pjesë në takimin e thirrur nga Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit të Kuvendit të Kosovës. Në takim ishin të gjitha institucionet e drejtësisë dhe u diskutuan të arriturat dhe adresimi i rekomandimeve dhe vlerësimeve të raportit të BE për Kosovën. Gjithashtu në

takim janë diskutuar edhe komentet në lidhje me kërkesën buxhetore për vitin 2021, ku AD ka prezantuar në të dy pikat e diskutuara dhe ka ngritë nevojën e aprovimit të kërkesës buxhetore si të aprovuar nga KD i AD , dhe parashtruar në fillim të vitit.

AD me kërkesë të Kryesuesit të KGJK -së dhe gjyqtarit kontaktues për nismën regjionale të mbështetur nga Departamenti i Administrimit të Drejtësisë së Norvegjisë, ka prezantuar praktikën në Kosovë në fushën e ligjit të procedurës kontestimore me theks në menaxhimin e shqyrtimit përgatitor dhe seancën kryesore.

Video-konferencë e TAIEX lidhur me themelimin e bashkëpunimit të Kosovës me Eurojust

3-4 Dhjetor 2020, Akademia e drejtësisë mori pjesë në Videokonferencën e organizuar nga TAIEX në bashkëpunim me EUROJUST lidhur me themelimin e bashkëpunimit Eurojust-Kosovë.

Qëllimi i këtij seminari të realizuar online është që të shpjegohen karakteristikat e bashkëpunimit me Eurojust dhe themelimi i kontakteve fillestare mes EUMS, Eurojust dhe autoriteteve të Kosovës.

U trajtuan tema të ndryshme siç janë Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar, shpëlarja e parave, krimi kibernetik dhe terrorizmi.

Kosovan në këtë Konferencë u prezantua nga spektër i gjerë i akterëve të sistemit të drejtësisë si dhe nga institucionet përgjegjëse për bashkëpunim juridik Ndërkombëtar.

Në këtë konferencë morën pjesë Ministri i Drejtësisë së Republikës së Kosovës z. Selim Selimi, Drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në kuadër të MD-së, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë z. Enver Fejzullahu, si dhe pikat kontaktuese nga Prokuroritë e Shtetit që janë përgjegjëse për BJN.

Temat që u mbuluan më në hollësi, gjithmonë me fokus në mënyrat e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar edhe me Eurojust ishin: Roli i Eurojust në luftën kundër krimit ndër-kufitar; Bashkëpunimi mes Eurojust dhe vendeve të treta; Bashkëpunimi në mes të Eurojust dhe

vendeve të Ballkanit Perëndimor; Prezantimi i Kosovës dhe kornizës së saj për bashkëpunim juridik – që u realizua nga z. Gazmend Çitaku Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Dita e dytë vijoi me trajtimin e këtyre temave: përshkrimi i mënyrës së funksionimit të praktikë të instrumenteve të përdorura nga Rrjeti i Ekipit të Përbashkët Hetimor në bashkëpunim me Eurojust; Prezantimi i punës strategjike të Eurojust të kryer nga grupi punues për çështjet kundër terrorizmit dhe krimit kibernetik, rrjet ky që mbështetet nga EJCN, si dhe mbrojtja e të dhënave personale në Eurojust.

Konferenca u përmbyll me diskutime të ndryshme nga të gjithë pjesëmarrësit të cilët gjithashtu parashtruan pyetje rreth funksionimit të Eurojust dhe krijimit të pikave kontaktuese me vendet e treta të Ballkanit Perëndimorë, organizimin e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve, krijimin e pikave kontaktuese dhe lidhjen e marrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Eurojust, përmirësimin e luftimit të krimeve ndër-kufitare, si dhe eksplorimit të formave potenciale të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Eurojust.

“Gazetaret dhe rreziqet e dhunës ndaj grave”

Këshilli i Evropës me 08 dhjetor 2020 organizoj tryezën e diskutimit mbi mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve me tematikë “Gazetaret dhe rreziqet e dhunës ndaj grave”. Tryeza e diskutimit u organizua në kuadër të Projektit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Liria e shprehjes dhe liria e mediave (JUFREX 2)” dhe projektit “Përforcimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - Faza II”. Tryeza u organizua gjatë fushatës “16 ditë aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore” dhe për qëllim kishte ndërgjegjësimin për rolin e rëndësishëm të mediave për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Që në fillim me nga një fjalë rasti u paraqitën znj. Gresa Musliu, Zyrtare e lartë e Projektit, JUFREX, z. Frank Power, Shef i Këshillit të Evropës - Zyra në Prishtinë, z. Naim Qelaj, Avokat i Popullit, z. Riccardo Serri, Shefi i Divizionit Politik, Ekonomik dhe Integritet Evropian në Zyrën e BE-së, znj. Jenny Stenberg Sorvold, zëvendës ambasadore, Ambasada Mbretërore Norvegjeze në Prishtinë. Në këtë tryezë nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës pjesëmarrës ishte z. Islam Sllamniku, trajnues gjyqësor i përhershëm.

Me prezantime të veçanta u paraqitën: znj. Gentiana Begolli-Pustina, Kryetare e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, znj. Merita Limani, Menaxhere e Projektit, Përforcimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje-Faza II, z. Besim Kelmendi, Koordinator nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit për trajtimin e rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, znj. Lambrini Papadopulos, gazetare, pjesëtare e grupit punues gjatë hartimit të Kursit HELP mbi Mbrojtjen dhe Sigurinë e gazetarëve dhe znj. Flutura Kusari, Juriste e së drejtës së mediave, konsulente e Këshillit të Evropës.

Në fillim u trajtuan çështjet lidhur me Sistemin ekzistues për raportimin dhe ndjekjen penale të sulmeve kundër gazetarëve, Numri i rasteve dhe trendi i rasteve të raportuara vecmas sulmet -

dhuna ndaj gazetarëve gra, Bashkëpunimi me platformat për promovimin e sigurisë së gazetarëve dhe Raportimi mediatik mbi dhunën ndaj grave dhe dhunës në familje - sfidat dhe mundësitë. Pastaj u zbërthyen standardet e Konventës së Stambollit të Këshillit të Evropës për rritjen e ndërgjegjësimin mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave - roli i mediave.

Një tematikë që u veçua ishte edhe Roli i Prokurorisë në hetimin e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve, Masat e ndërmarra për krijimin e një sistemi për trajtimin e rasteve të sulmeve fizike dhe verbale kundër gazetarëve, dhe Numri i rasteve me të cilat Prokuroria ka hetuar dhe është duke i hetuar aktualisht/sfidat në hetimin e rasteve.

Në vazhdim u trajtuan edhe Kërcënimet gjinore ndaj gazetarëve grave dhe burra si: cenzura, frikësimi dhe sulmet fizike dhe psikologjike kundër gazetarëve, Stereotipat gjinore dhe parimet e barazisë gjinore, Efektet e bullizmit në internet me fokus të veçantë tek gazetaret gra. Me dobi ishte edhe Prezantimi i kursit online HELP mbi Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gazetarëve.

Gjithashtu me interes ishte edhe trajtimi i Pasqyrës së situatës aktuale në vend mbi sigurinë e gazetarëve dhe pandëshkueshmërinë, vecmas te gazetaret gra, dhe Burimet kryesore të kërcënimeve: kërcënime fizike, online dhe sulmet ligjore me të cilat përballen gazetaret, Prezantim i mjeteve dhe mekanizmave ekzistues vendorë mbi sigurinë e gazetarëve. U trajtuan edhe paditë SLAPP - Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike.

Në këtë trajnim u prezantuan edhe materialet e reja dhe praktika gjyqësore aktuale e GJEDNJ në kontekstin e mbrojtjes dhe sigurisë së gazetarëve si dhe rreziqet e dhunës ndaj grave-gazetare. Në pjesën e fundit u zhvillua një diskutim me dobi ku morën pjesë të gjithë pjesëmarrësit.

Konferenca rajonale online "Mbrojtja e pronës: GJEDNJ dhe jurisprudenca kombëtare në Ballkanin Perëndimor"

Më 09 dhjetor 2020 Këshilli i Evropës organizoj Konferencën rajonale në internet me temë: "Mbrojtja e pronës: GJEDNJ dhe praktika gjyqësore kombëtare në Ballkanin Perëndimor". Qëllimi i kësaj konference ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me të drejtën e respektimit të pronës dhe mbrojtjes së saj konform standardeve që përmban Neni 1 i Protokollit 1. të KEDNJ dhe roli i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg si dhe jurisprudenca kombëtare në Ballkanin Perëndimor. Kjo konferencë u organizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës në kuadrin e Programit të Përbashkët "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022".

Që në fillim me nga një fjalë rasti u paraqitën z. Mikhail Lobov, Shefi i Departamentit për Bashkëpunim dhe Politikat e të Drejtave të Njeriut, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut dhe Shtetit të së Drejtës, Këshilli i Evropës, pastaj moderatori z. Sergey Dikman, Koordinator Programi, Departamenti për Zbatimin Kombëtar të të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës.

Në paraqitjen e parë fokusi ishte në temën: Qasjet dhe jurisprudenca relevante e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për të drejtën e mbrojtjes së pronës, ku me një prezantim u vequa moderatori: z. Andrey Esin, Avokat për të drejtat e njeriut, ish jurist i Regjistratit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Pastaj u zhvilluan diskutime përmbajtësore të iniciuara nga: znj. Ana Vilfan-Vospernik, juriste, Drejtoria e Juriskonsultës, Regjistri i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe z. Dragoljub Popović, ish-gjyqtar në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, i zgjedhur për Serbinë.

Në paraqitjen e dytë dominoi tema: "Problemet specifike dhe sfidat e reja sa i përket së drejtës për ta gëzuar paqësisht pronën (pjesa 1)" me

prezantim të moderatorit: z. Andrey Esin, Avokat për të drejtat e njeriut, duke u pasuar me diskutime të dobishme të iniciuara nga: znj. Elsa Toska, gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë; znj. Dušana Radović, gjyqtare në Gjykatën e Lartë të Malit të Zi; dhe znj. Sevima Sali-Terzić, Këshilltare Ligjore në Gjykatën Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Konferenca u përqendrua në shpjegimin e ndërhyrjes së domosdoshme në një shoqëri demokratike nga ana e autoriteteve kombëtare konform KEDNJ. Fokusi ishte edhe në shpjegimin e nocioneve dhe kategorive që përmban neni 1. i Protokollit 1, si dhe mënyra e interpretimit që bën GJEDNJ. Zbërthimi i të drejtave që përmbahen në këtë nenë të këtij Protokollit është i domosdoshëm për të kuptuar nocionet dhe mënyrën e interpretimit që bënë GJEDNJ.

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin përfaqësues të Gjykatave Kushtetuese, Gjykatave të Larta, Gjykatave të Apelit, Ministrive të Drejtësisë, institucioneve kombëtare të trajnimit, Agjentëve Qeveritarë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Dhomave të Avokatisë, shoqatave profesionale të gjyqtarëve nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Kosova dhe përfaqësues të Sekretariatit të Këshillit të Evropës dhe Regjistratit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Konferenca u përmyll me rekomandimet përfundimtare, vlerësimet nga pjesëmarrësit si dhe fjalën përfundimtare të z. Sergey Dikman, Koordinator Programi, Departamenti për Zbatimin Kombëtar të të Drejtave të Njeriut nga Këshilli i Evropës. Konferenca u mbajt në gjuhën angleze por përkthimi simultan ishte siguruar edhe në gjuhën shqipe, maqedonase dhe boshnjake/kroate/malazeze dhe serbe.

Akademia e Drejtësisë merr pjesë në ndarjen e çmimeve për praktikën më të mirë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve

10 Dhjetor 2020, Akademia e Drejtësisë mori pjesë në ceremoninë për ndarjen e çmimeve “Praktika më e mirë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve”, që u organizua në formë të uebinarit nga Zyra e Komisionerit për gjuhët (ZKGJ) në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE).

Në këtë ceremoni, ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme, u theksua rëndësia e përdorimit të gjuhëve zyrtare nga ana e institucioneve pasi që paraqet respektimin e të drejtave të të gjithë qytetarëve dhe qasjen e barabartë në shërbimet që ofrohen nga institucionet.

Të pranishmëve ju drejtuan Komisioneri për Gjuhët z. Slaviša Mladenović, dhe Ambasadori I Misionit të OSBE-së në Kosovë, z. Jaan Brathu.

Ndarja e çmimit, siç u tha në ceremoni, u bë në bazë të monitorimit të përdorimit të gjuhëve zyrtare në ueb faqet zyrtare të ministrive, organeve ekzekutive dhe agjencive duke përfshirë edhe rrjetet sociale të institucioneve përkatëse.


Çmimin e parë këtë vit Komisioneri për gjuhët e ndau për institucionet si, Ministria e

Financave, Komuna e Prishtinës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Gjykata Kushtetuese dhe Banka Qendrore e Kosovës.

Në mesin e institucioneve tjera që kanë treguar performancë të mirë në zbatimin e ligjit për gjuhët zyrtare radhitet edhe Akademia e Drejtësisë, e cila do të pranojë mirënjohje dhe pajisje të vogla si kufje përkthimit dhe usb.

Gjatë ceremonisë, me një fjalë rasti para të pranishmëve kanë folur edhe Kryetari i Komunës së Prishtinës z. Shpend Ahmeti, përfaqësues nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, zv. Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, znj. Magbule Shkodra, përfaqësues nga Auditori Gjeneral, Ombudspersoni dhe të tjerë.

Nga të gjithë të pranishmit dhe fituesit e shpërblimeve u potencua se ky çmim tregon përkushtimin e gjithë stafit për të respektuar detyrimet kushtetuese e ligjore dhe se ky çmim do të jetë edhe një shtytje për të punuar në vazhdimësi drejt avancimit dhe barazisë në respektimin e të drejtave gjuhësore dhe lirive në përgjithësi.



Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë


Më 30 dhjetor 2020, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë. Takimi është realizuar në formë virtuale përmes platformës ZOOM dhe është udhëhequr nga Kryesuesi z. Enver Peci, njëherësh, Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi dhe vendosja për metodologjinë e punës në zbatim të aktiviteteve trajnuese për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe çështje tjera me rëndësi në kuadër të mandatit ligjor për funksionimin më të mirë të Akademisë së Drejtësisë.

Sipas agjendës së përcaktuar për këtë takim, në përbërje të plotë Këshilli Drejtues diskutoi dhe miratoi procesverbalin nga takimi i datës 30 nëntor 2020 i këtij organi, vendosi për shpalljen publike për zgjedhjen e trajnuesve të

përkohshëm të AD-së, si dhe për aplikimin e bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit tjetër administrativ gjyqësor dhe prokurorial në trajnimet e vazhdueshme. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe kërkesa e z. Ismet Salihu për çështjen e botimit të enciklopedisë me ç ‘rast u miratua rekomandimi i Departamentit për Administratë dhe Financa si dhe u diskutua lidhur me statusin e të punësuarve në Akademinë e Drejtësisë dhe mundësia që statusi i tyre të jetë i ngjashëm me statusin e të punësuarve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Në këtë takim Këshilli Drejtues diskutoi edhe çështje të tjera të cilat janë në dobi të funksionimit të mirë të punës së Akademisë së Drejtësisë në kuadër të kompetencave dhe mandatit ligjor të saj.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Hartimi i moduleve trajnuese

Edhe gjatë muajit dhjetor është vazhduar me përgatitjet për trajnimin fillestar për gjyqtarët që priten të dekretohen së shpejti meqë 22 kandidatë potencial për gjyqtarë i kanë kaluar gjitha fazat e rekrutimit në KGJK.

Prandaj, Akademia e Drejtësisë vazhdon procesin e hartimit të moduleve trajnuese sipas përmbajtjes së përcaktuar nga ky program, si dhe materialet tjera përcjellëse.

Në periudhën raportuese janë finalizuar modulet si në vijim: Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinore si dhe Legjislacioni dhe Shkathtësitë plotësuese ndërkaq janë në proces të finalizimit moduli për Kodin Penal dhe

Kodin e Procedurës Penale si dhe moduli për të drejtën civile, administrative dhe ekonomike.

Po ashtu është vazhduar me procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hartimit të programit trajnues për prokurorët e rinj për të cilët ka filluar procesi i rekrutimit nga KPK.

Bazuar në metodologjinë për vlerësim të nevojave trajnuese ky proces është në fazën e përpunimit të propozimeve të dala nga mekanizmat vlerësues.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Program i Specializuar Trajnimi – Shpëlarja e Parave-Sesioni III

Më 01 -02 dhjetor 2020 , Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me programin IRZ organizoi sesionin e trajnimit me temën Program i Specializuar Trajnimi – Shpëlarja e Parave-Sesioni III “.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me infrastrukturën ligjore për luftimin e shpëlarjes së parave dhe zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore dhe procedurës me rastin e hetimit dhe gjyqimit të rasteve përkatëse.

Gjatë këtij trajnimi On-line në platformën Zoom u trajtuan veprat penale të shpëlarjes së parave duke vënë në pah format apo veprimet që duhet ndërmarrë në këto raste si dhe problemet të cilat paraqiten në praktikë qoftë gjatë hetimeve ashtu edhe gjatë zgjidhjes së rasteve. Vëmendje të veçantë kishte sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar me veprën penale, bashkëpunimi juridik ndërkufitar dhe ndërkombëtarë për luftimin e pastrimit të parasë si dhe zgjidhjet e mundshme alternative. Gjithashtu u fokusua edhe në sanksionet penale

ndaj kryerësve të veprës penale të pastrimit të parave dhe rastet kur personat shpallen fajtor për pastrim të parave pa u shpallur fajtor për veprën penale bazë.

Me rastin e këtij trajnimi u potencua që shpëlarja e parave kategorizohet ndër krimet më serioze, e cila ka për qëllim ta atakojë zhvillimin ekonomik të shoqërisë. Në vijim u tha që si formë e kriminalitetit manifestohet në forma të ndryshme si: evazionet fiskale, aktivitete të ndryshme kriminale, pastrimi i parave, etj., të cilat kryhen me ndërmarrjen e aktiviteteve kriminale.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit patën mundësinë e diskutimit dhe komentimit të rasteve të ndryshme dhe gjatë fazës së përgatitjes së rasteve për gjykatë duke zhbërthyer dhe interpretuar dispozitat ligjore që i sanksionojnë këto vepra.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar dhe prokuror nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Trajnimi: E Drejta e Azilit dhe legjislacioni në fuqi

Më 08 dhjetor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me GIZ – Projekti për Reformat Ligjore dhe Administrative LARP, ka realizuar trajnimin online përmes platformës Zoom me temë “E Drejta e Azilit dhe legjislacioni në fuqi”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e azilit.

Gjatë këtij trajnimi u trajtua e drejta e azilit dhe legjislacioni në fuqi; Raporti i Ligjit për Azil të Kosovës me Konventën Ndërkombëtare për Refugjatë; Dispozitat e LKA-së për iniciimin e konfliktit administrativ në rastet e azilit dhe vendosja e rasteve të qëndrimit të përkohshëm të të huajve.


Në fillim të trajnimit u diskutua se me ligjin nr. L06/L-026 për azil rregullohen kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azil kërkuesve, personave me status refugjat, si dhe personave tjerë të cilëve i është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme. Më je u potencua se refugjati është personi i cili për shkak të frikës së bazuar mirë për të qenë i

persekutuar për arsye të racës, religjionit, kombësisë, bindjes politike apo përkatësisë së grupit të caktuar shoqëror, është jashtë vendit të shtetësisë dhe nuk ka mundësi apo për shkak të frikës së tillë nuk ka dëshirë të kthehet në atë vend.

Më tutje është diskutuar për iniciimin e konfliktit administrativ për të drejtën e azilit ku procedura e Konfliktit Administrativ është e rregulluar me ligjin nr. 03 / L 202. Me këtë ligj rregullohen kompetenca, përbërja e gjykatës dhe rregullat e procedurës, në bazë të të cilave gjykatat kompetente vendosin për ligjshmërinë e akteve administrative me të cilat organet kompetente të administratës publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik dhe të palëve tjera, si dhe për ligjshmërinë e veprimeve të organeve administrative.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar nga Gjykata e Apelit, gjyqtar dhe prokuror nga niveli themelor.



Trajnimi: Ligji për pyjet e Kosovës, Mbrojtjen e natyrës dhe Mbrojtjen e ambientit

Më 15 Dhjetor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me projektin GIZ/LARP, organizoj trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Ligji për Pyjet e Kosovës, Mbrojtjen e Natyrës dhe Mbrojtjen e Ambientit”.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me degradimin e mjedisit, dëmtimit të pa mëshirshëm të pyjeve, të parqeve kombëtare dhe të natyrës në përgjithësi e cila reflekton detyrimisht në shëndetin e njeriut dhe në cilësinë e jetës në përgjithësi si dhe zbatimi i drejtë i ligjit në praktikë përkatësisht dispozitave që rregullojnë këtë fushë në rastet e tilla.

Gjatë këtij trajnimi vëmendje të veçantë kishte elaborimi i dispozitave ligjore të Ligjit për Pyjet e Kosovës, Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligjit për Mbrojtjen e Ambientit në procedurën

kundërvajtëse,. Po ashtu ndërlihdja e Ligjit për Pyjet e Kosovës me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligjit për Mbrojtjen e Ambientit në procedurën kundërvajtëse duke vënë në pah dilemat dhe paqartësitë me rastin e zbatimit në procedurat kundërvajtëse.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, paraqitja e këndvështrimeve të pjesëmarrësve, prezantimi përmes PowerPoint, pyetje-përgjigjet dhe analizimi i rasteve nga praktika.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarët nga gjykata Themelore të divizioneve për kundërvajtje dhe divizioni penal nga të gjitha regjionet e Kosovës dhe prokuror nga Departamenti i përgjithshëm.



Trajnimi: Komentimi i vendimeve të gjykatave - Harmonizimi në çështjet detyrimore

Më 18 dhjetor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me projektin e BE-së Mbështetje e Kodit Civil Faza 2, kanë realizuar tryezën online përmes platformës Zoom me temë “Komentimi i vendimeve të gjykatave – Harmonizimi në çështjet detyrimore”.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me komentimin e vendimeve të gjykatave – harmonizimin në çështjet detyrimore.

Gjatë kësaj tryeze u trajtua Harmonizimi i vendimeve gjyqësore në lëndët civile/Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve; Kontratat e pavlefshme dhe Kompensimi i dëmit.

Në fillim të tryezës u diskutua për punët juridike me theks të veçantë shprehja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, me qëllim që të krijoj, ndryshoj ose të shuaj të drejta ose detyrimet civile e të cilat mund të mund të jenë punë juridike të njëanshme apo të dyanshme.

Më tutje është diskutuar për pavlefshmërinë absolute të punëve juridike të cilët janë ato punë juridike të cilat parashihen me ligj e që për pasojë ka pavlefshmërinë në kuptim absolut. Në vazhdim u tha që këto punë juridike janë të pavlefshme që do të thotë se nuk prodhojnë efekte juridike prej momentit të krijimit të tyre. Në bazë të Nenit 58 të draftit të Kodit Civil parashihen kushtet që të ekzistojnë pavlefshmëria absolute, ndërsa pavlefshmëria relative e punëve juridike shfaqët si rezultat i aftësisë në rastet kur pala apo palët kanë aftësi të kufizuar të veprimit, kur kemi të bëjmë me mungesa të vullnetit të palëve si rezultat i kanosjes, mashtrimit, lajthimit apo nevojës ekstreme.

Metodologjia e tryezës ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke përdorur raste studimore të aktgjykimeve dhe duke i diskutuar dhe trajtuar çështjeve më sfiduese gjatë zgjidhjes së rasteve. Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtar nga gjitha regjionet e Kosovës nga Departamenti Civil.

Tryezë: Komentimi i vendimeve të gjykatave - Harmonizimi në çështjet trashëgimore

Më 15 dhjetor 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e BE Mbështetje Kodit Civil Faza 2, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme realizoi Tryezën përmes platformës Zoom me temë “Harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështjet trashëgimore”.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me Procedurat e shqyrtimit të trashëgimisë dhe Harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështjet trashëgimore.


Gjatë kësaj tryeze u komentuan vendime të shumta gjyqësore të cilat janë paraqitur në praktikë nëpër gjykatat e Kosovës për rastet e Trashëgimisë, për të cilat u vunë në pah çështjet më sfiduese në këto raste. Në vijim u trajtuan evidentimi i pasurisë trashëgimore sipas Kodit Civil, trashëgimtarët e domosdoshëm dhe

ndarja e pasurisë së trashëgimisë në raste kontesti sipas Kodit Civil.

Në mënyrë të hollësishme u elaborua si fitohet e drejta në trashëgimi, cilët persona kanë të drejtë në trashëgimi, parimi i barazisë në trashëgimi dhe si inicohet procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore. Me theks të veçantë u diskutua lidhur me qasjen e noterëve dhe gjyqtarëve që trajtojnë rastet në procedurat e trashëgimisë, në sistemin e regjistrimit civil dhe regjistrimit kadastral.


Gjatë kësaj tryeze diskutimet ishin përmes komentimit të vendimeve gjyqësore të cilat janë paraqitur në praktikë nëpër gjykatat e Kosovës.

Përfitues të këtij trajnimit ishin: gjyqtar nga të gjitha Regjionet e Kosovës.



Punëtori: Angazhimi i fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara

Më 15 dhjetor 2020, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), organizoi Punëtorinë e dytë me




radhë, me temë: “Angazhimi i fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara”.

Qëllimi i Punëtorisë ishte nxjerrja e rekomandimeve përfundimtare rreth kësaj teme, si dhe validimi i materialit të përgatitur nga profesori universitar Prof. Dr. Bedri Bahtiri.

Gjatë punëtorisë janë diskutuar edhe çështje praktike nga rastet në Gjykata dhe Prokurori, çështjet të cilat janë primare për t’u trajtuar në modulën trajnues, mënyra e trajtimit të rasteve, kornizën ligjore në Kosovë etj.

Përfitues të kësaj Punëtorie ishin Gjyqtarët dhe Prokurorët nga Departamenti për të Mitur.

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, dhe rekomandimeve të IKSHP-së, punëtorja u zhvillua në mënyrë virtuale përmes platformës ZOOM.



Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Trajnimi: Menaxhimi i TIK-ut

Më 10 dhjetor, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Menaxhimi i TIK-ut”.

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me përdorimin e sistemeve elektronike, ngritjen e nivelit të komunikimit elektronik si dhe ofrimin e shërbimeve administrative të besueshme dhe efikase duke përdorur teknologjinë informative.


Në fokus të trajnimit ishte: Përdorim i pajisjeve të TI-së; Komunikimi elektronik dhe Siguria e Informacionit. Me rastin e këtij trajnimi u theksua që digjitalizimi i plotë i proceseve të punës është një ndër sfidat që kërkon trajnime të vazhduara të prokurorëve, gjyqtarëve dhe stafit administrativ në

përdorimin dhe zbatimin e TIK, pasi që ndikon në ofrimin e shërbimeve cilësore, të shpejta dhe të sakta, si dhe në gjenerimin e raporteve në kohë reale.

Në trajnim u veçua se në sistemin gjyqësor dhe prokurorial vazhdimisht janë duke u ndërmarr veprime për futjen e teknologjisë informative (TIK) dhe sistemeve elektronike në përdorim, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe transparencës në punë.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në prezantim të shkurtër të koncepteve përmes teknikave moderne trajnuese, diskutimeve interaktive me pjesëmarrës (pyetje e përgjigje).

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Stafit administrativ nga gjykatat dhe prokuroritë.



Trajnimi: Menaxhimi i kohës dhe stresit

Më 16 -17 dhjetor, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Menaxhimi i kohës dhe stresit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zhvillimi i shkathtësive të pjesëmarrësve lidhur me menaxhimin e kohës dhe stresit si një predispozitë e përmirësimit të performancës së tyre gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tyre të përcaktuara me ligj në funksion të mbështetjes së punës dhe rritjes së efikasitetit të punës së Gjykatave dhe Prokurorive.


Në ditën e parë të këtij trajnimi u trajtuan: Stresi dhe përkufizimi teorik, menaxhimi i kohës si dhe priorizimi i aktiviteteve. Ndërsa në ditën e dytë u trajtuan: Teknikat e ruajtjes së shëndetit dhe kondicionit të punës, ruajtja nga “djegia” e profesionit.

Me rastin e këtij trajnimi u theksuan cilat janë mënyrat me të mira për largimin e stresit dhe cilat janë instrumentet e menaxhimit të kohës.

Gjithashtu u potencua që menaxhimi i kohës dhe i stresit është nevojë imediate si parandalim i atakimit të personaliteteve të zyrtarëve në administratë në rastin konkret nga ana e stresorëve të ndryshëm në mënyrë që puna e tyre të jetë cilësore dhe efikase.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi janë: Stafi administrativ nga gjykatat dhe prokuroritë.



Trajnimi: Të drejtat e njeriut dhe garancitë juridike dhe procedurale për mbrojtjen e tyre

Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e UNDP-së me datën 23-24 dhjetor 2020 ka realizuar trajnimin dyditor online përmes platformës Zoom, me temën: “Të drejtat e njeriut dhe garancitë juridike dhe procedurale për mbrojtjen e tyre”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të zyrtarëve administrativ dhe bashkëpunëtorëve profesional në gjykata dhe prokurori në tematikën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së tyre.

Në këtë trajnim në ditën e parë u trajtuan temat në vijim: Të kuptuarit e të drejtave të njeriut, Tipologjia e klasifikimit, Detyrimet pozitive dhe testi i proporcionalitetit, E drejta në mjete juridike efektive, Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut, Mbrojtja kushtetuese e lirive dhe të drejtave themelore (neni 113, parag. 7 i Kushtetutës së Kosovës) dhe zbatimi gjyqësor i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në ditën e dytë është fokusuar në: Kornizën juridike dhe institucionale mbi qasjen në drejtësi në rastet kundër diskriminimit, Procedurën gjyqësore për mbrojtje juridike kundër diskriminimit (Roli i gjykatave në luftimin e diskriminimit, Barra e provave, Përcaktimi i dëmit, Sanksionet, Mbrojtja gjyqësore e së drejtës kundër mos-diskriminimit me vështrim të veçantë në KEDNJ) dhe raste të përzgjedhura nga praktika gjyqësore nacionale dhe GJEDNJ-së.

Gjatë këtij trajnimi u vu në pah se diversiteti

dhe mosdiskriminimi janë elemente bazë të një shoqërie bashkëkohore, ndërkaq zhvillimi i një sistemi ligjor demokratik nuk mund të paramendohet pa një legjislacion që ndalon të gjitha format e diskriminimit. Në të gjitha dokumentet ndërkombëtare dhe rajonale që rregullojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, tani përfshihen dispozitat për ndalimin e diskriminimit. Në këtë kontekst edhe legjislacioni kundër diskriminimit i Kosovës paraqet një kornizë ligjore cilësore për luftimin e diskriminimit në të gjitha sferat e jetës publike, si dhe drejt eliminimit të fenomenit të trajtimit të pabarabartë të individëve. Në Republikën e Kosovës, vetëdijesimi i shoqërisë në lidhje me parimin e diskriminimit dhe luftës kundër tij është ende i ulët. Të gjitha raportet mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, në veçanti ato që kanë të bëjnë me grupet e ashtuquajtura ‘të cenueshme’ të njerëzve siç janë personat me aftësi të kufizuara, femrat, fëmijët, etj., bëjnë fjalë për marginalizim të këtyre kategorive të njerëzve, duke konfirmuar kështu praninë e praktikave diskriminuese në të gjitha sferat e jetës publike.

Në këtë trajnim u zbërthyen temat në fjalë të shoqëruara me raste nga praktika gjyqësore aktuale e GJEDNJ në kontekstin e antidskriminimit dhe u analizuan disa raste të përzgjedhura nga praktika relevante e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, diskutime në grup dhe shqyrtime përfundimtare ku morën pjesë të gjithë pjesëmarrësit. Gjithashtu edhe interpretime të dispozitave Ligjit Kundër Diskriminimit dhe dispozitave tjera në fuqi që rregullojnë këtë tematikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin zyrtarët administrativ dhe bashkëpunëtorët profesional në gjykata dhe prokurori të Republikës së Kosovës.

Aktivitetet për Profesionet e Lira

“ Mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës së përmbaruesve privat ”

Më 03 dhjetor 2020, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin në bashkëpunim me Odën e Përmbaruesve Privat me temë: “Mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës së përmbaruesve privat”.

Ky trajnim u mbajt virtualisht (platforma zoom) dhe kishte për qëllim avancimin e njohurive të pjesëmarrësve me autorizimet dhe rolin e institucioneve mbikëqyrëse lidhur me inspektimin e përmbaruesve privat.

Në pjesën e parë të trajnimit fokusi ishte në: Institucionet për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së përmbaruesve privat dhe autorizimet e tyre, Të Drejtat dhe detyrimet e përmbaruesve të inspektuar dhe autorizimet e zyrtarëve inspektues, Burimet e informacionit në procesin e mbikëqyrjes dhe Procesi i inspektimit të përmbaruesve privat. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Mbikëqyrja jashtë zyrës së përmbaruesit privat, Inspektimi në zyrën e përmbaruesit privat dhe Inspektimi periodik dhe i veçantë.

Që në fillim të trajnimit u theksua se Përmbaruesit privat kryejnë autorizime publike të besuara sipas legjislacionit në fuqi, vendosin për veprimet nga kompetenca e tyre në zbatimin e përmbarimit të lejuar dhe ndërmarrin veprime për përmbarim. Në vazhdim u potencua se për të ndërmarrë kontrollin e cilësisë së procedurave të përmbarimit, shteti vendosë kornizë të qartë ligjore si dhe standarde që synojnë të realizojnë çdo vit përmes një sistemi të pavarur rishikimin dhe inspektimin e përmbarimit (Udhëzimet e CEPEJ, 2009). Pra, shteti duhet të siguroj që aktivitetet e përmbaruesve privat të vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme. Republika e Kosovës tashmë ka krijuar një kornizë për organizimin dhe funksionimin e mbikëqyrjes së ligjshmërisë së punës së përmbaruesve privat.

Dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktojnë inspektimin e punës së përmbaruesve privat dhe autorizimet e autoriteteve përgjegjëse për inspektim. Ndërsa Udhëzuesi për mbikëqyrjen e punës së përmbaruesve (2017) shërben si mjet praktikë për mbikëqyrjen e punës së përmbaruesve privat.



Më tej u theksua se Përmbaruesi privat duhet t'i nënshtrohet rregullave të caktuara etike dhe të sjelljes. Kodi i Përkohshëm MD-Nr.07/2014 i Etikës së Përmbaruesve Privat përcakton parimet sipas të cilave përmbaruesit privat duhet të sillen në punën e tyre. Parimet e përcaktuara në këtë Kod janë në pajtim me parimet e etikës profesionale të përmbaruesve evropian dhe më gjerë. Gjithashtu u potencua se fushëveprimi i mbikëqyrjes nuk përfshin vetëm ligjshmërinë e veprimeve të përmbaruesit privat, por edhe punën etike dhe efektive të përmbaruesit privat.



Rëndësi iu kushtua edhe rolit të autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen ose kontrollin e përmbaruesve privat, njohjen e përmbaruesve privat me të drejtat dhe detyrimet gjatë procesit të inspektimit, procesin e inspektimit si dhe llojet e inspektimeve të përmbaruesve privat.



Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit teorik, interpretime të thelluara të ligjit, duke u bazuar në raste praktike dhe shoqëruar me diskutime interaktive dhe analizës së dispozitave ligjore që përmban Ligji për Procedurën Përmbarimore dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë këtë tematikë.

Përfitues në këtë trajnim ishin përmbaruesit privat nga të gjitha regjionet e Republikës së Kosovës.

Vijueshmëria në trajnime në PTV e prezantuar përmes grafikoneve







Kurset e mësimit në distancë-Elearning

Gjatë muajit dhjetor platforma e mësimit në distancë ka vazhduar të jetë e hapur për pjesëmarrësit e interesuar (Gjyqtarë, Prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive si dhe për studentët e Fakulteteve Juridike) pa afat të caktuar kohor.

Në kuadrin e kësaj platforme janë 19 kurse të çashtme online, 11 prej të cilave edhe në gjuhën serbe.

Më 20 korrik 2020, sipas Rregullores së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Nr. 06/2019) për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Nr. 06/2017) është lëshuar online edhe kursi obligativ “Etika profesionale” për gjyqtarët e Republikës së Kosovës.

Për në detaje janë tabelat të cilat prezantojnë vijueshmërinë dhe progresin në ndjekjen e kurseve sipas temës në këtë platformë.

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore (Shqip)</i>	284	83%	32	9%	25	7%
<i>Etika Profesionale I</i>	284	83%	39	11%	18	5%
<i>Etika Profesionale II</i>	286	84%	25	7%	30	9%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore (Serbisht)</i>	33	10%	20	6%	288	84%
<i>Etika Profesionale I (Serbisht)</i>	32	9%	98	29%	211	62%
<i>Etika Profesionale II (Serbisht)</i>	34	10%	53	16%	254	74%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Masat e Diversitetit</i>	5	4%	11	9%	102	86%
<i>Masat e Diversitetit (Serbisht)</i>	0	0	0	0	14	100%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Menaxhimi Efektiv</i>	3	18%	12	71%	2	12%
<i>Menaxhimi Efektiv (Serbisht)</i>	0	0	0	0	13	100%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Drejtësia për fëmijë aspekti Civil</i>	18	15%	20	17%	80	68%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Drejtësia për fëmijë aspekti Penal</i>	12	10%	16	14%	90	76%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Hetimi dhe zbulimi i Korrupsionit</i>	13	11%	9	8%	96	81%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Korrupsioni sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar</i>	8	7%	8	7%	102	86%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Menaxhimi i Gjykatës</i>	14	12%	6	5%	98	83%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Udhëheqësia - Liderhipi</i>	12	10%	9	8%	97	82%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike Shq (Shqip)</i>	10	8%	19	16%	89	75%
<i>E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike (Serbisht)</i>	3	21%	6	43%	5	36%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Faza e aktakuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Shqip)</i>	21	18%	16	14%	81	69%
<i>Faza e aktakuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Serbisht)</i>	2	14%	4	29%	8	57%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Menaxhimi i stresit (Shqip)</i>	39	33%	21	18%	58	49%
<i>Menaxhimi i stresit (Sërbisht)</i>	7	50%	3	21%	4	29%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Shkathësitë e komunikimit social (Shqip)</i>	9	8%	8	7%	96	85%
<i>Shkathësitë e komunikimit social (Sërbisht)</i>	2	15%	4	31%	7	54%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Trajnimi për implementimin e legjislacionit tati-mor në Kosovë (Shqip)</i>	7	6%	6	5%	100	88%
<i>Trajnimi për implementimin e legjislacionit tati-mor në Kosovë (Sërbisht)</i>	2	15%	3	23%	8	62%


Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Shqip)</i>	16	14%	43	36%	59	50%
<i>Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Sërbisht)</i>	1	15%	4	31%	7	54%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Anglishtja Ligjore</i>	39	35%	23	20%	51	45%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Teknologjia Informativë</i>	32	28%	14	12%	67	59%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Dhuna në Familje (Shqip)</i>	0	0%	24	86%	4	14%
<i>Dhuna në Familje (Sërbisht)</i>	0	0%	3	11%	25	89%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqin dja	Në Progres	Përqin dja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Mbajtja e shënimeve për Interpret Gjyqësor</i>	4	33%	5	42%	3	25%
<i>Mbajtja e shënimeve për Interpret Gjyqësor (Serbisht)</i>	1	8%	3	25%	8	67%



Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 200 18 660
E-mail: infoad@rks-gov.net
<https://ad.rks-gov.net>